

Medkhalijet dhe Sururijet, një vështrim i shkurtër mbi dy lëvizjet që i përkatësohen Selefizmit

I gjithë falënderimi i takon All-llahut, Zotit të krijesave. Lusim All-llahun që ta përmendë Pejgamberin tonë në shoqëritë më fisnike dhe t’i sigurojë atij mirëqënie.

Sa i përket asaj që vijon:

Njerëzit atribojnë vetët e tyre me Selefin për të fituar legjitimitet ndaj veprave të tyre, ngase ndjekja e Selefit është e urdhëruar dhe nëpërmjet ndjekjës së tyre arrihet kënaqësia e All-llahut. Kështu që, Ai ﷻ thotë, (kuptimi)

"All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij." [1]

Dhe transmetohet nga Ahmedi, et-Tirmidhiu, Ebu Davudi, ibni Maxheja dhe të tjerë, se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë,

"Është detyrë mbi ju që të pasoni Sunetin tim dhe Sunetin e Hulefai-Rashidinëve pas meje. Kapeni dhe shtrëngojeni atë (Sunetin) me dhëmballat tuaja. (Dhe) Kini kujdes nga shpikjet; se me të vërtetë çdo shpikje është bidat dhe se çdo bidat është devijim."

Ndjekja e Selefit, nënkupton ndjekjën e rrugës së vërtetë të legjisluar nga All-llahu dhe i Dërguari tij ﷺ. Kështu që nuk është çudi që shumë grupe përkatësojnë vetet e tyre se janë ndjekës të Selefit. Por qëllimi përfundimtar në fakt është ndjekja e Selefit në besimin dhe veprat e tyre, dhe jo vetëm ndjekja e tyre me fjalë.

Këtu ne (në këtë ese) duam ti hedhim një sy dy prej grupeve bashkëkohore që përkatësojnë vetet e tyre si ndjekës të Selefit por vetëm me gojët e tyre dhe duke kundërshtuar besimin e tyre (të Selefit) nga ana tjetër.

---

[1] Sureja et-Teube, Ajeti 100.

El-Medkhalije (Rabijovcat)

Grupi i parë prej tyre janë Medkhalijet, të njohur në vendet tona edhe si "Rabijovca".
Emrin e tyre e kanë marrë nga Rabi el-Medkhali [2] dhe filluan të shfaqen në vitet e 90'ta në Gadishullin Arabik për të vepruar si kundër-balancë i kritikave që bëheshin kundër regjimit Saudit për punën e lejimit të hyrjës së kufarëve në Gadishullin e Profetit ﷺ. Regjimi Saudit pasi panë avantazhin e të pasurit këlyshë që flisnin gjuhën 'Selefije' në anën e tyre, me shpejtësi përkrahën ideologjitë dhe shkollat e tyre. Pas regjimit Saudit, gjithashtu edhe Egjipti së bashku me shtetet tjera Arabe, filluan që ti përkrahin ata (Medkhalijet) dhe ti vëndosin në fuqi. Sot, sidoqoftë, baza e tyre kryesore gjendet në Europë (selia qëndrore e tyre është në Angli). Agjencitë e intelegjencës në Perendim i konsiderojnë ata (Medkhalijet) si aleat i kryqëzatave moderne 'kundër luftës ndaj terrorit'.[3]

Shtylla kryesore e shkollës Medkhalije është nënshtrimi absolut i tyre ndaj qeverive, posaçërisht ndaj regjimit Saudit edhe pse ato qeveri dihet mirë se nuk sundojnë me ligjin e All-llahut dhe janë aleat me mushrikët kundër njësuesve. Medkhalijet haptazi mbështesin llojet e këtyre qeverive (që nuk sundojnë me ligjin e All-llahut dhe janë

[2] Gomar i ligë, nga Saudia Arabite.
[3] Më konkretisht luftës kundër Shtetit Islam.

aleat të mushrikëve) dhe etiketojnë si Havarixh çdo kënd i cili nuk pajtohet me ta në këtë çështje edhe pse dijetarët kanë rënë dakord se, gjykimi me ndonjë ligj tjetër që bie në kundërshtim me ligjin e All-llahut është vepër e cila e largon njeriun nga Islami, kurse Medkhalijet nuk pranojnë këtë mendim duke thënë se (mos gjykimi me Sheriat) është prej punëve të zemrës dhe nuk mund ne ta dimë se sunduesi preferon ligjet e shpikura nga njeriu mbi ligjet e All-llahut vetëm atëherë kur ai e shpreh atë me gojë. Në këtë mënyrë të njëjtë ata arsyetohen edhe atëherë kur sunduesit e tyre bëhen aleatë me mushrikët kundër Muslimanëve.

Medkhalijet në vend që të diskutojnë për çështjet e lartëpërmendura janë të zënë duke i akuzuar njerëzit që i kundërshtojnë ata me lloj-lloj emrash.[4] Kur vendosin të diskutojnë për sunduesit e tyre felëshues, gjithmonë luajnë rolin e asaj se kinse Selefët kanë ndaluar nga rebelimi kundër tyre (sunduesve), duke i konsideruar ata si sundues zullumqarë e jo felëshues. (Edhe pse felëshimi i tyre është shumë e qartë.)
Medkhalijet refuzojnë ndjekjën e ndonjërit prej katër medh-hebeve lidhur me fikhun. Megjithatë në të kundërtën e kësaj janë ndjekës të verbër të dijetarëve bashkëkohor në çështje të akidës dhe menhexhit, posaçërisht xherhut (kritikës) dhe tebdijës (shpalljen e dikujt si bidatçi). Në kohën e më hershme xherhu, ka qenë term i përdorur nga dijetarët e Hadithit, për të

[4] I akuzojnë si Havarixhë, Kutbistë (emër i dhënë pas Sejid Kutbit, Allahu e pranoftë si shehid) bëjnë hallall spiunimin e tyre në organet e shtetit, i konsiderojnë sikur teprues në fe, e shumë e shumë akuza tjera (sh.p)

filtruar transmetuesit e dobët dhe të lënë (që nuk ju merret parasysh transmetimi) nga ata që kanë qenë të besueshëm. Me vonë, kur në librat e Hadithit u përmblodhën sasi të mjafueshme të Haditheve, ky term filloi të përdoret për atë se nga cili dijetarë duhet të merret dhe mos të merret dituria.

Medkhalijet janë teprues në xherh dhe tebdi dhe çdoherë keqpërdorin parimin se 'kush nuk e shpallë bidatçiun si të tillë, është vetë bidatçi.' Rast më konkret është ai me Sejid Kutbin (Allahu e pranoftë si shehid) me të cilin Medkhalijet janë të fiksuar. Dhe thonë se 'kush nuk e shpall atë (Sejid Kutbin) si bidatçi; është vetë bidatçi, dhe kush do që nuk e shpall bidatçi atë i cili u përmbajtë për ta shpallur atë (Sejid Kutbin) si të tillë, gjithashtu edhe ai është bidatçi.' Po kështu njejtë janë të fiksuar edhe për ta mbrojtur udhëheqësin e tyre Rabij' El-Medkhalin dhe ekzagjërojnë me lavdërime ndaj tij për ti trembur kundërshtarët e tyre. Tek ata asnjëherë ai (Rabij' El-Medkhali) nuk pyetet se përse bëri diçka; çdo gjë që ai thotë kalon tek ata pa asnjë problem. Përkundrazi, të tjerët pyetën për të (se çfarë mendimi kanë për të). Nëse dikush flet mirë për të, ai në sytë e tyre është 'Selefi'. Në të kundërtën kush flet diçka të keqe nuk është. (Selefi) Nëse flasim për atë se si ata (Medkhalijet) e kuptojnë imanin (besimin) dhe të kundërten e tij kufrin; Medkhalijët janë të zhytur ne irxha – disa prej tyre më shumë e disa më pak. Ata të zhyturit më pak thonë se 'veprat janë prej besimit dhe prej shtyllave të tij' ndërsa

të zhyturit më thellë thonë se 'ata (veprat) janë prej imanit; por janë kusht për përsosmërinë e tij (imanit) dhe jo prezencës së imanit në zemër'.[5] *Këtë mendim ata e kanë marrë nga el-Albani.*[6] *Pa marrë parasysh se çfarë thonë ata teoritikisht, Medkhalijet nuk shpallin askë si pabesimtar kur dikush vepron ndonjë vepër të kufrit, përpos nësë ai (vepruesi) nuk e pranon se atë e ka pasur me zemër.*

Gjithashtu një tipar tjetër dallues i tyre është se ata bëjnë Xhihad vetëm atëherë kur regjimi Saudit thotë se është Xhihad, si për shembull Xhihadi në Afganistan kundër Rusëve sipas tyre ishte Xhihad legjitim sepse atë e lejonte regjimi Saudit, ndërsa Xhihadi tjetër në Afganistan kundër kryqëzatave Amerikane nuk ishte Xhihad legjitim vetëm sepse regjimi Saudit nuk e konsideronte atë si të tillë.

Drejtuesit e këtij sekti të prishur dhe thirrësve të tij përfshijnë këta emra: Muhammed el Xhami, Rabij' el-Medkhali, Ubejd el-Xhabir, Falah Mandakar, Abdul-Aziz er-Rajjis, Selim et-Teuil. Ndërsa në anën Angleze: Abu Hadixhe, Musa Riçardson. etj.
Gjithashtu edhe disa emra më pak të njohur si Ebu Usameh, Abdur-Rahman Hassan, Abu Tejmijje, Imran ibn Mensur i njohur edhe si 'DawahMan' në YouTube edhe pse kanë mosmarrëveshje të vogla me llojin sikur Ebu

[5] D.m.th sipas tyre njeriu edhe nëse nuk bënë vepra për të treguar imanin e tij, imani është prezent në zemër dhe kjo mjafton.
[6] Muhaddithi i njohur shqiptar Nasiruddin el-Albani.

Hadixhe dhe të tjerëve, mund të themi se edhe ata bien në këtë grup. (Pra konsiderohen Medkhalije.)

Me pak fjalë, Medkhalijët janë ashtu sikurse kanë thënë dijetarët; '(Bëhen) Havarixh të ashpër kur bëhet fjalë për muslimanë dhe thirrës në rrugën e vërtetë të Selefit, dhe nga ana tjetër bëhen Murxhie felëshues kur bëhet fjalë për pabesimtarët'.

Es-Sururijeh

Grupi i dytë ndoshta më pak i njohur, është emëruar pas Muhammed Surur Zejn El-Abidin, një ish anëtar i 'Vëllazërisë Islame'. (Ikhvanul Muslimin të Egjiptit)

Janë të dalluar nga ajo, se punojnë në fshehtësi. Ata paraqiten si Selefi dhe përkrahin Teuhidin, Xhihadin dhe ndalimin nga e keqja, por nën këto janë të ngjashëm me 'Vëllazërinë Islame' (ihvancat) në qasjet dhe mendimet e tyre.

Në fillimet e tyre Sururijet kritikonin regjimet e tagutit të cilët bënin aleanca me mushrikët kundër Muslimanëve, megjithatë ju shmangën çështjeve të tekfirit dhe Xhihadit ndaj tyre. Pas shtypjëve të shumta nga ana e regjimit Saudit, sulmit të 11 shtatorit dhe kryqëzatës së re. Ata rregulluan marrëdhëniet me ta dhe u bënë agjent

aktiv të tyre. Rast konkret është ai i Sefer el-Hauali, i cili ishte udhëheqës i Sururijëve që në vitet e 90'ta, ishte kritikues i madh i regjimit Saudit, por pas burgosjës tij në vitin 1994 deri në vitin 1999 ai u bë një prej agjentëve më të mëdhenj në rradhët e tagutëve për kapjën dhe burgosjën e Muxhahidëve në Gadishullin Arabik.

Realiteti i tyre u ekspozua edhe më shumë, atëherë kur Muxhahidët në vitin 2006 shpallën Shtetin Islam. Atëbotë Sururijet të udhëhequr nga Nasir el-Umeri, i cili u angazhua me të madhe për të prishur planin e Muxhahidëve, duke përkrahur 'Partinë Islame' në Irak pastaj edhe 'Ushtrinë Islame të Irakut' dërisa u bashkuan të gjithë këta grupe kundër Muxhahidëve duke formuar të ashtuquajturën 'Sahva'. Kështu Sururijet duke zgjedhur ligjet e tagutit mbi ligjin e të Gjithëfuqishmit, u bashkuan me kryqëzatat amerikane kundër Shtetit Islam, në të njejtën mënyrë sikurse bëjnë edhe sot.

Njësoj sikurse edhe Medkhalijet, Sururijet luftojnë kundër secilit që vendos Teuhidin dhe mohimin e tagutit në Tokë, akuzojnë Muxhahidët se kinse ata janë Havarixh dhe bëjnë hallall gjakun e tyre.

Pas pranverës Arabe, 'Vëllazëria Islame' dhe Sururijet forcuan raportët mes vete, të dy grupet sëbashku duke shtrembëruar Teuhidin, krijuan partitë e tyre politike në këtë mënyrë duke lejuar votimet për hir të dobisë. Sidoqoftë, fuqia e tyre nuk zgjati për shum kohë, ngase 'Vëllazëria Islame' humbi përkrahjën në shum vende, dhe nga ana tjetër konflikti mes regjimit Saudit dhe

Sururijeve përsëri filloi të eskalojë, por këtë herë ishte për shkak konfliktëve të Shteteve Arabe me Katarin (i cili është financues i madh i 'Vëllazërisë Islame' dhe gjithashtu aleat kryesor i Sururijeve).

Në lidhje me kuptimin e tyre rreth imanit dhe kufrit, mund të themi se janë me të mirë se Medkhalijet, përshkak se ata (Sururijet) sundimin me ligj tjetër pos ligjit All-llahut e konsiderojnë kufër, gjithashtu bërjën e aleancës me mushrikët kundër Muslimanëve e konsiderojnë kufër. Gjithë kjo bie poshtë kur vie në pyetje zbatimi i këtyre parimeve. Ngase, sipas Sururijeve, Muhammed Mursi dhe Rexhep Tajip Erdogani janë Muslimanë, dhe ushtritë e tyre janë Muxhahidinë.

Dijetarët e tyre kryesorë janë; Muhammed Sururi, Selman El-Audeh, Nasir el-Umeri, Sefer el-Hauali, dhe Abdul-Aziz et-Tarifiu. Secili i cili shihet duke i marrë këta njerëz si dijetarë të tyre, në mënyrë të sigurtë mund të supozojmë se është nga Sururijet.

Shkurtimisht mund të përmblidhet se Sururijet janë 'Ihvanca' me shije 'Selefijje'.